



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr.144, datë 30.10.2020

PËR

TRAJTIMIN ME SUBVENCIONIN E QIRASË TË DISA FAMILJEVE NË NEVOJË QË NUK MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË E TREGUT TË LIRË

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, vendimit nr. 301, datë 15.04.2020, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit”, vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, bazuar në vendimin e marrë nga Komisioni i Strehimit, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë trajtimin me subvencionin e qirasë për individët/ familjet, sipas listës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
 2. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë për individët/familjet e përcaktuara në pikën 1, do të jetë për një periudhë 1 (një vjeçare), nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi.
 3. Për individët/familjet, e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, kryerja e pagesave do të kryhet pasi të dorëzohet numri i llogarisë së qiradhënësit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale.
 3. Efektet financiare që rrjedhin nga pika “1”, në shumën prej **165100 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e njëqind) lekë** në muaj, do të përballohen nga fondi i përcaktuar nga zëri i bonusit të strehimit të buxhetit të Bashkisë Tiranë.
 4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R

TONI GOGU